



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 22 GUSHT 2019**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 22. AVGUSTA 2019. GODINE**

**GUSHT - GUSHT  
2019**

## **Rendi i ditës**

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2018 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian,
2. Shqyrtimi i propozimit të Grupit të deputetëve për shpërndarjen e Legjislaturës së Gjashtë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

## **Dnevni red**

1. Razmatranje Nacrt zakona o ratifikaciji finansijskog Sporazuma IPA 2018 između Kosova e Evropse unije,
2. Razmatranje predloga grupe poslanika za rašpustanje VI saziva Skupštine Republike Kosovo.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
Urime, ta kryejmë shpejt për çfarë kemi ardhur.

I hap punimet e seancës plenare, pastaj secili në fushatë elektorale.

Janë dy pika të rendit të ditës:

### **1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2018 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian**

Komisioni Funkcional për Integritet Evropian e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2018 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Në qoftë se donë, fjalën mund ta marrë ministrja, kryetarja e komisionit, grupet parlamentare, ose shkojmë drejt në votimin e amendamenteve, të jemi më ekspeditivë.

Ka pasur një dakordancë të të gjitha grupeve parlamentare për shkak të rëndësisë së kësaj pike, interesi strategjik nacional.

A i votojmë dy amendamentet?

Atëherë, janë dy amendamente, të cilat për miratimin e tyre duhen së paku 80 vota për.

Regjia dhe deputetët të përgatitet për votim:

Amendamentet 1 dhe 2 i votojmë përnjëherë. 103 deputetë janë prezentë në sallë.

Përgatitemi për votim, votojmë tash!

96 kanë votuar për. Kalojnë dy amendamentet.

Atëherë i ftoj deputetët për votimin e projektligjit në tërësi me amendamentet.

Mirë është, megjithatë 96, vetëm konstatojmë edhe sa vota ishin me dorë, administrata, për konstatim. Me sa po shoh unë, janë tre. 101, minimum, ishin vota për.

Do të thotë, shkojmë në votimin në tërësi të projektligjit me amendamentet e miratuara, votojmë tash!

101 deputetë kanë votuar në mënyrë elektronike, me aq sa pashë, edhe dy deputetë me dorë, 103, të gjithë për.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-161 për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2018 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

## **2. Shqyrtimi i propozimit të grupit të deputetëve për shpërndarjen e Legjislaturës së Gjashtë të Kuvendit të Republikës së Kosovës**

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, më 5 gusht 2019, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare kemi vendosur që Kuvendit t'i propozohet shpërndarja e Legjislaturës së gjashtë, pas dorëheqjes së kryeministrit në largim të Kosovës, zotit Ramush Haradinaj.

Ndërkohë grupet parlamentare kanë mbledhur 98 nënshkrime të deputetëve për mbështetjen e propozimit për shpërndarjen e kësaj legjislature.

Ftoj deputetin Memli Krasniqi, që në emër të 98 deputetëve nënshkrues të këtij propozimi, ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozimin për shpërndarjen e Legjislaturës së gjashtë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Urdhëro, zoti Krasniqi!

**MEMLI KRASNIQI:** I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Në bazë të nenit 82, paragrafi 1, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, propozojmë për shqyrtim në këtë seancë mocionin për shpërndarje të Legjislaturës së gjashtë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ky mocion është në pajtim me qëndrimet e shprehura nga të gjitha grupet parlamentare në mbledhjen e Kryesisë, me kryetarët e grupeve parlamentare të iniciuar nga kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli, të mbajtur më 5 gusht 2019. Faleminderit!

**KRYETARI:** A të shkojmë drejt në votim, nuk ka asnjë të paraqitur, nuk ishte askush i paraqitur deri në këtë sekondë, shkojmë në shpërndarje tash.

Shkojmë në debat, dëshirojmë që kurrë të mos ketë më Kuvend më dembel se sa këtë herë.

Atëherë, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë.

Seanca e sotme i përmbyll punimet e kësaj legjislature.

Për dy vjet, në këtë Kuvend rrallë kemi debatuar për zhvillim ekonomik, për avancimet në arsim e shëndetësi.

Shumicën e kohës jemi marrë:

- me parandalimin e koalicionit PAN, mbështetur nga PSD-ja, që të hyjë në dialog me Serbinë në kundërshtim me Kushtetutën,
- me ndërhyrjen e Kryeministrit në drejtësi apo në agjencitë e pavarura,
- me shkeljet e ligjore në deportimin e shtetasve të huaj,
- me tentativën e koalicionit PAN për t'iu ikur obligimeve ndërkombëtare,
- me faljen e taksave apo shpenzimin e rezervës pa përfillur ligjin,
- me Presidentin, pasi ai nuk i kryente obligimet kushtetuese.

Kështu që, kjo legjislaturë ka qenë arenë konfrontimesh pozitive - opozitive për ta ruajtur ligjshmërinë dhe Kushtetutën e Kosovës, e jo debat për avancimin e politikave në interes të qytetarëve.

Si opozitë, kemi pasur përballë një koalicion prej 24 partive, por që përfaqësonin vetëm 1/3 e elektoratit, një koalicion pa legjitimitet, jo profesional, me vendimmarrje ad hoc të bazuar në interesa politike dhe të grupeve të interesit.

Si rezultat, është realizuar vetëm 30% e agjendës legjislative, dhe atë nga vullneti i opozitës për të mbështetur disa ligje specifike.

Prandaj, kjo legjislaturë po mbyllet me shumë seanca të hapura, me mbi 100 pika në pritje për miratim, si ligje, raporte, rezoluta, zgjedhje të bordeve etj.

Të nderuar deputetë,

Qeveria e PAN-it do të mbetet në histori si Qeveria më e madhe në botë, me 454 anëtarë:

- Kryeministri me 35 këshilltarë,
- 5 zv.kryeministra me 55 këshilltarë,
- 21 ministra me 147 këshilltarë,
- 80 zëvendësministra me 80 këshilltarë,

- 5 koordinatorë, me nën-koordinatorë dhe asistentë të nënkoordinatorëve.

Përtej këtyre:

- u punësuan 1 245 veta me kontratë, prej tyre 95 në Zyrën e Kryeministrit.
- u punësuan 200 të afërm të partive në pushtet në Telekom, ndërkohë në sektorin privat u mbyllën 26 000 vende pune.

Rreth 1/3 e ministrave kanë qenë me aktakuzë.

Kjo Qeveri do të mbahet mend për shkeljet e të drejtave njerëzore në dëbimin e të huajve.

Komisioni Hetimor ka evidentuar 31 shkelje të procedurave ligjore, por përgjegjësinë nuk e mori askush. Tash vonë, u bënë kurban disa policë e zyrtarë të thjeshtë.

Qeveria e PAN-it, me vendime joligjore, e ka dëmtuar buxhetin me rreth 200 milionë:

- 60 mil. nga falja e borxheve të kompanive private,
- 53 mil. për “Bechtel-Enka” pa vlerësim nga kompania mbikëqyrëse,
- dyfishimi i pagës për kabinetin prej 454 personave,
- miliona euro nga shpronësimet për nevojat e KEK-ut,
- subvencione për frizere, roleta e fasada,
- kontrata të dëmshme për lobim,
- shpenzime nga kartelat kreditore pa arsyetim,
- 800 mijë euro për projektin “Ta pastrojmë Kosovën”,
- 315 mijë euro subvencione për persona fizikë,
- shpenzim i rezervës pa ligj dhe vendime të tjera.

Në anën tjetër, dialogu me Serbinë:

- u nis pa konsensus politik,
- u udhëhoq nga njerëz pa legjitimitet, dhe
- me përfshirjen e Presidentit jashtë mandatit kushtetues.
- në fillim të mandatit, Kryeministri tentoi, në mënyrë jo kushtetuese, ta bartte dialogun tek Presidenti.

- Pas një inxhinjeringu politik të pa precedent, u themelua Ekipi Negociator, i cili me angazhimin e opozitës u shpall jokushtetues.

Programi Qeverisës 2017-2021, i cili iu paraqit Kuvendit në fillim të mandatit, nuk u mor parasysh në asnjë veprim të Qeverisë. Reformat e premtuara në ekonomi, arsim e shëndetësi nuk

kanë qenë në rend dite. Në shëndetësi gjendja nuk ka qenë asnjëherë më keq. Papunësia është rritur. Kushtet e të bërit biznes janë përkeqësuar dhe investimet e jashtme janë përgjysmuar.

Korrigjimi i marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi, që u premtua të kryhej për tre muaj, u harrua. Në mbledhjen e parë të Qeverisë u shkarkua Komisioni Shtetëror për Kufirin. Por, në fund, Qeveria e miratoi raportin e Komisionit të shkarkuar. Ndërkaq, AAK dhe NISMA e votuan marrëveshjen, duke e larë veten me një amendament në ligj që ka vetëm karakter informues.

Në marrëdhëniet ndërkombëtare, mandati i qeverisë së PAN-it u mbyll pa liberalizim të vizave, pa anëtarësim në Interpol, pa njohjeve dhe me skandale të ministrit të Jashtëm:

- Në Uashington, Pacolli e ftoi ministrin e Jashtëm serb që të angazhohet për krijimin e një zone ekonomike në veri,
- Në OKB deklaroi se është aty me lejen e Serbisë, se shqiptarët dhe serbët nuk kanë pasur konflikt dhe se nuk duhet të ketë kufi mes dy popujve,
- E irritoi kryeministrin e Marokut me fotografi nga takimi joformal me të.

Ka pasur edhe skandale të tjera:

- Ministrja e Ambientit shkoi në Kanada për aheng familjar, por e paraqiti si takim në selinë e NATO-s,
- Provimin e Noterisë e kaluan vetëm të afërm të partive në pushtet,
- Kryeministri takoi në zyrë personin kryesor të krimit e korrupsionit në veri,
- Presidenti punësoi për dy vite një agjent të shërbimit sekret serb,
- Kryeministri mbante një këshilltare, për të cilën AKI-ja ngriti dyshime.
- Kryeministri dhe disa deputetë ofenduan dhe kërcënuan prokurorin Blakaj, i cili po i hetonte listat e veteranëve, dhe dy deputetë u paraburgosën për këtë.

Qeveria PAN i ka dhënë vulë nepotizmit dhe politizimit në punësime.

Sigurisht, se ka pasur arritje gjatë këtyre dy vjetëve, siç është fillimi i transformimit të FSK-së, statuti i Trepçës, disa ligje në drejtësi etj.

- Por, duhet thënë se në mungesë të shumicës parlamentare, këto arritje kanë ndodhur vetëm si rezultat i përkrahjes së opozitës.

- Megjithatë, çfarëdo arritje ka mbetur nën hijen e skandaleve, korrupsionit e nepotizmit enorm. Të nderuar deputetë,

Përpjekjet e opozitës që, në mënyrë kushtetuese, të mbikëqyrë dhe të kërkojë llogari ndaj pushtetit kanë hasur në arrogancë.

Qeveria e ka injoruar Kuvendin, duke e shkelur një obligim kushtetues. Kryeministri dhe ministrat rrallë kanë marrë pjesë në seanca të Kuvendit. Ministrat kanë refuzuar të paraqiten në komisione dhe shpesh kanë përdorur gjuhë jo parlamentare.

Karshi kësaj situatë, si opozitë, kemi përdorur fuqinë e votës për të dëshmuar mungesën e legjitimitetit të koalicionit PAN për të qeverisur me vendin.

Një opozitarizëm i ngjeshur i LDK-së, në bashkëpunim me pjesën tjetër të opozitës, i fokusuar në çështje themelore nacionale, ka bërë që të pamundësohen vendime të dëmshme për shtetin e Kosovës.

- Kemi ngritur 39 çështje nga fusha e ekonomisë, sigurisë, shëndetësisë, arsimit si dhe çështje politike.
- Kemi parashtruar 124 pyetje parlamentare, por shumica pa përgjigje.
- Kemi thirrur 8 interpelanca, prej tyre 7 me Kryeministrin.
- Kemi thirrur 16 debate parlamentare.
- Kemi arritur të miratojmë 5 rezoluta, por që nuk janë zbatuar.
- Kemi propozuar, dhe janë formuar, dy komisioneve hetimore.
- Kemi fituar një rast në Gjykatën Kushtetuese, ligji për dialogun me Serbinë.

Në disa legjislatura të Kuvendit, marrë së bashku, nuk ka pasur kaq shumë aktivitet opozitar.

Por, le të përgjigjemi, shumë thjeshtë, në dy çështje:

- E para, në çfarë gjendje kjo qeveri e ka marrë mandatin në shtator 2017?
- Dhe e dyta, si është gjendja tani, pas dy vjetëve, kur po e dorëzon mandatin?

Shifrat flasin vetë. Gjendja është përkeqësuar sipas cilitdo tregues.

Prandaj, zgjedhjet janë mënyra e vetme për të kthyer normalitetin, duke larguar këtë model qeverisës arbitrar, që shkel ligjet dhe kushtetutën, të korruptuar dhe nepotist.

Vetëm përmes zgjedhjeve mund t'i japim fund kësaj qeverie:

- të kaosit, zhvatjes së buxhetit dhe izolimit të Kosovës,
- të dështimit në diplomaci dhe çnjohjeve,
- të ministrave me aktakuza,
- që bashkëpunon me njerëz të kimit,
- që urdhëron e kërcënon prokurorë, - që i refuzohet viza nga vendi më mik i Kosovës,
- që ndan buxhet për frizere e roleta,
- që merr vendime për interesa të këshilltarëve të vet,



- që ia dyfishon pagën vetes,
- që ndan pronën publike mbi baza diskriminuese dhe nacionalizon pronën private kundërligjshëm.

Kosovës i duhet një qeverisje:

- normale dhe pro-evropiane, në kuptimin e plotë të fjalës,
- që ka pjekuri politike,
- që respekton rendin kushtetues dhe ndarjen e pushteteve.

Nëpërmjet zgjedhjeve të lira, ne do t'i japim Kosovës një qeveri të tillë, me njerëz kompetentë e atdhetarë.

Në fillim, pas sanimit të dëmeve që po i lë prapa qeveria e PAN-it, do të ndërmarim reforma rrënjësore në ekonomi, arsim dhe shëndetësi, siguri nacionale, integritet rajonale dhe euroatlantike, por mbi të gjitha në sundim të ligjit, luftim të korrupsionit dhe eliminim të nepotizmit.

(i) Në fushën e ekonomisë:

- bizneset do të marrin prapë frymë lirisht, pa u përkëdhelur askush e pa i rënë në qafë kujt, përfshirë këtu eliminim e monopoleve jo ligjore.
- Do të zbatohet plotësisht Pakoja Fiskale 2, që ka mbetur përgjysmë, dhe bashkë me bizneset do të përgatitet Pakoja Fiskale 3.
- Buxheti do të arrijë menjëherë 3 miliard.
- Do të finalizohet bashkimi i ATK-së me Doganat, që është harruar, si dhe fiskalizimi online i bizneseve.
- Bujqit do të mbështeten më shumë, por bazuar në sasinë e prodhimit.
- Bjeshkët dhe lumenjtë do të ruhen, e do të rishikohen licencat e dhëna pa përmbushur kushtet ambientaliste.

(ii) Arsimi:

- do të lirohet nga diktati i kryeministrit dhe ministrit të arsimit.
- politikat arsimore do të përgatiten nga profesionistët, me fokus në cilësi dhe gjithëpërfshirje.
- librat e nxënësve nuk do të shkruhen nga njerëz që nuk e kuptojnë ku kanë arritur standardet e të nxënësve në shekullin XXI.

(iii) Në shëndetësi:

- urgjentisht do të funksionalizohen sigurimet shëndetësore.
- Investimet publike do të shkojnë në modernizim të shëndetësisë.

(iv) Në fushën e rendit dhe ligjit:

- na duhet rishikim funksional që siguron sistem efikas.
- Policia do të jetë efikase në gjithë Kosovën, jo vetëm nëpërmjet aksioneve policore të njehershme.
- gjykatësit dhe prokurorët nuk do të guxojë t'i urdhërojnë dhe kërcënojnë kush.
- Ministri i Drejtësisë do të qëndrojë larg Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial.

(v) Diplomacia:

- do të jetë profesionale, duke eliminuar nepotizmin dhe politizimin.
- do të ndërmarrim një rishikim funksional të rrjetit të diplomacisë, pasi ambasadat janë mbushur me militantë e njerëz jo kompetent.
- ambasadat do të mbështeten me atashe ekonomik, ushtarak, policor, kulturor e arsimor, për të fuqizuar bashkëpunimin me shtetet mikpritëse, për të mbështetur qytetarët tanë në ato vende dhe për të promovuar mundësitë për investime në Kosovë.

(vi) Në aspektin sigurisë:

- Kosova do të jetë faktor paqe e stabiliteti në rajon.
- FSK-ja, me dyfish më shumë buxhet, do të përgatitet për tu avancuar drejt ushtrisë, nëpartneritet me NATO-n dhe vendet mike.
- Shërbimi ushtarak do të jetë i obligueshëm, në përputhje me standardet e vendeve anëtare të NATO-s.

(vii) Integrimet rajonale:

- do të thellohen krahas integrimit evropian.
- me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut do të arrihen marrëveshje të veçanta për bashkëpunim ekonomik, pika doganore të unifikuara, unifikim i tregut energjetik me Shqipërinë, arsim i lartë i integruar, kalendar të përbashkët kulturor dhe fusha të tjera të bashkëpunimit.

Qeverisja e jonë do të përfshijë bashkëpunimin e ngushtë me: biznese, me rini, me bujq, me ekspertë shëndetësorë e arsimorë, me mjekë e arsimtarë, me komunitetin kulturor, me shoqërinë civile, me sindikata, me oda ekonomike, me profesionistë të fushave të ndryshme, e me qytetarë në gjithë Kosovën.

Ky Program Qeverisës, bashkë me një ekip të njerëzve kompetentë e atdhetarë, njerëz me duar të pastra, që respektojnë Kushtetutën e Kosovës, do t'ju prezantohet qytetarëve të Kosovës për të marrë besimin e tyre.

Prandaj, të nderuar deputetë, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, ju ftoj të votojmë për shpërndarjen e Kuvendit për të hapur rrugë për zgjedhje të reja. Faleminderit.

**KRYETARI:** Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Para se të vazhdoj te Memli Krasniqi, kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, ka shumë deputetë të paraqitur. Kjo është marrëveshje të cilën e përcaktojnë grupet parlamentare. Ne e kemi nënshkruar një mocion të gjithë bashkërisht për ta shpërndarë Kuvendin. Në qoftë se, futemi pas përfaqësuesve të grupeve parlamentare te deputetët, atëherë shkohet të gjithë të diskutojnë. Kështu që kryetarët e grupeve parlamentare të më tregojnë saktësisht, a dëshirojnë të kenë debat për ta shtyrë vendimmarrjen, apo dëshirojnë të shkojnë në vendimmarrje pas përcaktimit të fjalëve të kryetarëve të grupeve parlamentare?

Shkoni ku të doni, se pa shkuar në zgjedhje sot s'bën. Po i marr mendimet. Më së pari, me aq sa po shoh, Avdullah Hoti.

**AVDULLAH HOTI:** Ne mendojmë se duhet të ketë debat në këtë seancë përmbyllëse të kësaj legjislature.

**KRYETARI:** Memli Krasniqi, e ke fjalën. Por, kisha pasur dëshirë edhe deklarimet e tyre, në fund të fundit e hedh në votim te ju. Shkojmë...

**MEMLI KRASNIQI:** Zoti kryetar!

Ne kemi pasur një mbledhje, në të cilën e kemi pasur një dakordim shumë të mirë të gjitha grupet parlamentare dhe jemi pajtuar që sot të vijmë këtu e ta shpërndajmë Legjislaturën e Gjashtë dhe mendimi ynë është që për ta kryer këtë punë sa më shpejt, para gjysmës së ditës, secili kryetar i grupit, ashtu siç e bëri Avdullahu, mund t'i shprehë qëndrimet e grupit që përfaqëson dhe të kalojmë drejtpërdrejt në votim. Përndryshe, ne mund t'i dëgjojmë sot dhe nesër 80 fjalime, por unë besoj që Kuvendi duhet të shpërndahet sot menjëherë, e jo të shfrytëzohet tash për 80 fjalime fushatë zgjedhore, gjë që do ta shtynte pastaj shpërndarjen për nesër, ose një ditë tjetër.

Unë konsideroj që nëse dëshirojmë të shkojmë në debat, kjo është më shumë tendencë për të mos u shpërndarë Kuvendi sot, ndërsa si PDK dëshirojmë ta shpërndajmë Kuvendin tash menjëherë.

**KRYETARI:** Faleminderit!

Ju kisha lutur vetëm qetësi. Gjithsesi, ti je shef i të pagrupëve, po flas për Islam Pacollin, e ka kërkuar fjalën. Glauk Konjufca, urdhëro!

**GLAUK KONJUFCA:** Ne gjithmonë kemi qenë në favor të diskutimit dhe mendojmë që kjo është njëra prej të drejtave më fundamentale dhe të rëndësishme të deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kështu që gjithmonë jemi për ta përkrahur diskutimin, por kësaj radhe Vetëvendosja do të jetë shumë më ekonomike, sepse mendojmë që shpërndarja e Kuvendit është

akti më i rëndësishëm. Prej nesh do të flasë vetëm një deputet dhe do të shkojmë në shpërndarje të Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Mos u mërzitni, në fund e vë në mocion procedural, si të doni ju vetë. Shkojmë tek Ahmet Isufi.

**AHMET ISUFI:** I nderuar kryetar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Kabinet qeveritar,

Ne sot jemi në një seancë e cila e përcakton rrugën për të shkuar në zgjedhje. Kemi folur dy vjet rresht në këtë Kuvend. Konsideroj që shefat e grupeve parlamentare i përfaqësojnë grupet dhe mund të flasim në emër të tyre, nëse duam të jemi racionalë, përndryshe është e drejtë e deputetëve të diskutojnë, por meqë është seanca e fundit t'i lëmë pak lezet në njëfarë mënyre edhe kësaj shpërndarjeje dhe të shkojmë në zgjedhje.

Konsideroj se kjo është më e mira. Flasim në fushatë. Jemi që vetëm kryetarët e grupeve parlamentare ta kryejnë fjalën në emër të grupeve. Faleminderit!

**KRYETARI:** Dardan Sejdiu nga PSD-ja. Në fund e vë në votim. Mos u mërzitni, e vë në votim edhe atë tjetrën.

**DARDAN SEJDIU:** I nderuar kryetar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate është i mendimit që të ecim në shpërndarje sa më shpejt, pra vetëm shefat e grupeve ta thonë një fjalë të tyre, ata që mendojnë se duhet dhënë një fjalë, dhe të ecim në shpërndarje të Kuvendit, në votim për shpërndarje të Kuvendit sa më shpejt.

Siç është thënë tash e ca kohë, zgjedhjet janë zgjidhja, kështu që..., apo si ishte...?

**KRYETARI:** Faleminderit! Bilall Sherifi, kryetar.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, kryetar!  
Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Nisma mendon që duhet të vazhdojmë me nivel nga një përfaqësues i grupeve parlamentare, jo pse jemi kundër debatit, por sepse besojmë që debatin tash do ta zhvendosim në studiot televizive. Pra, kjo sot është veç sa për të filluar dhe vazhdojmë të shihemi nëpër studiot televizive, shihemi nëpër tubime dhe pastaj le të vendosë sovranin se kë do ta risjellë këtu dhe sa do të jetë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! 6+-i, Alberti, kryetari apo cili?

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pasi po e shohim se ka deputetë që shumica e deputetëve të flasin, unë mendoj se mirë do të kishte qenë, ne mendojmë si grup që vetëm kryetarët e grupeve parlamentare të deklarohen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka, edhe Islami me çdo kusht po kërkon prej të pagrupëve, OK, fjala edhe për ty. Cili është qëndrimi juaj?

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryetar!

Ju përshëndes, kolegë të nderuar!

Sigurisht që edhe ne e kërkojmë njëjtë fjalën, sikur të tjerët, në emër të AKR-së.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, ka qëndrime të ndara. Një grup parlamentar ishte për ta vazhduar debatin, Lidhja Demokratike e Kosovës, shumica e të tjerëve kishin qëndrim që të shkojmë në shpërndarje drejtpërdrejtë në votim. A e hedh në votim, në qoftë se shkojmë 51%, po e vë që të shkojmë drejt në votim ose në debat.

*(Ndërprerje e incizimit)*

Zoti Hoti merr përgjegjësi, dhe e kryejmë këtë mandat. Cili është qëndrimi, të shkoj edhe te grupet parlamentare për mocionin.

*(Ndërprerje e incizimit)*

Hajde, a shkojmë në votim për të shpërndarë Kuvendin? Përgatituni! Regjia, deputetët të përgatiten për shpërndarjen e Kuvendit, mos e lodhni popullin. 45 ditë, ose 30 ditë i keni për fushatë. E bëj për hir të qytetarëve.

*(Polemikë në sallë)*

Mocion? A doni mocion? Shkojmë në mocion procedural. Shkojmë!

Unë nuk marr vendim arbitrar, s'kam marrë... Unë ju respektoj, pavarësisht për çfarëdo qëndrimi jam falënderues për punën e përbashkët. Momenti ka ardhur për shpërndarjen e këtij Kuvendit. Shkojmë me mocion procedural, të votojmë direkt, pa debat për votimin direkt, mocion procedural për të shkuar në votim, drejt në votim. Herën e parë, hajde ju lutem, përgatitemi për votim, mocion procedural për shkuarje drejt në votim të shpërndarjes së Kuvendit.

Votojmë! Armendi po thotë “Hidhe menjëherë!” A e vë menjëherë? E shoh, menjëherë. Shkojmë në mocion procedural, se kryetari i Grupit Parlamentar po insiston, mocion procedural. Votojmë tash për shkuarjen e drejtpërdrejtë në votimin e shpërndarjes së Kuvendit. Votojmë tash!

105 deputetë janë në sallë, 76 veta, një deputet aq shumë, prej ditës së parë kur ka dhënë kryeministri dorëheqje kemi qenë entuziastë për të shkuar në zgjedhje, kështu që po shkojmë. Faleminderit të gjithëve!

Përgatitemi për votim. Jemi te pika, të mos bëjmë... vetëm pak...

Të nderuar deputetë, s’e paskemi kolegun Adem Mikullovc, se po flas shpejt. Ishalla s’... E përsëndes.

Ju njoftoj se në bazë të nenit 82, paragrafi 1, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shpërndarja e Kuvendit bëhet me 2/3-at e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Pra, nevojiten të paktën 80 vota për.

Vazhdojmë me votimin e propozimit për shpërndarjen e Legjislaturës së Gjashtë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm aktualisht 106 deputetë, që është numër i mjaftueshëm për procedim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Ju lutem, veç për konstatim. Arben, veç ti je me dorë, me sa po e shoh.

91 deputetë kanë votuar nga 105, 88 për, Arbeni 1, a është për? 89. Një kundër, dy abstenime.

Kuvendi vendosi shpërndarjen e Legjislaturës së Gjashtë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Vendimi i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dekretim, në pajtim me nenin 82, paragrafi 1, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Urime të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës!

Faleminderit, të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*